HOROSKOPI

Kronikë

Shkodër/ U kapën me kokainë në Shirokë, arrestohen dy 22-vjeçarë! Njëri prej tyre kishte municion luftarak në shtëpi

Dy të rinj janë arrestuar ditën e sotme pasi u kapën në flagrancë në Shirokë, me doza kokaine të cilat pretendohet se ishin për shitje.

Redaksia
14 Prill, 12:36 | **Përditësimi: 14 Prill, 12:48**

Share

SHKODËR – Dy të rinj janë arrestuar ditën e sotme pasi u kapën në flagrancë në Shirokë, me doza kokaine të cilat pretendohet se ishin për shitje.

Dy të rinjtë të identifikuar me inicialet Xh. C., 22 vjeç dhe F. M., 22 vjeç, po udhëtonin me makinë kur u ndaluan për një kontroll nga patrulla e policisë.

Nga kontrolli fizik dhe ai i makinës, blutë kanë gjetur doza lënde narkotike kokainë dhe 1 peshore elektronike.

LEXO EDHE:
Shkodër, zjarri shkrumbon 52 vjeçarin brenda në banesën e tij në Zogaj, shpëton gruaja e fëmijët! Dëshmitari: Zjarrfikësja erdhi me vonesë (EMRI+VIDEO)

Për më tepër, gjatë kontrollit të banesës së 22-vjeçarit të identifikuar me inicialet Xh.C., policia kanë gjetur një sasi municioni luftarak, që u sekuestrua në cilësinë e provës materiale, bashkë me sasinë e kokainës, peshoren elektronike dhe automjetin me të cilin u kapën në flagrancë 2 të arrestuarit.

Arrestimi i dy të rinjve u bë në kuadër të megaoperacionit "Tempulli 2".

"Në vijim të punës operacionale me fokus goditjen e veprimtarive kriminale në fushën e narkotikëve dhe si rezultat i administrimit të shpejtë të informacioneve nga inteligjenca policore, të siguruara në vijim të megaoperacionit antidrogë të koduar "Tempulli 2", shërbimet e Komisariatit të Policisë Shkodër, në bashkëpunim me specialistët e Seksionit për Hetimin e Narkotikëve, kanë goditur një rast të shitjes së lëndëve narkotike, në doza, për të cilin u arrestuan në flagrancë shtetasit Xh. C., 22 vjeç dhe F. M., 22 vjeç.

Në Shirokë, shërbimet e Patrullës së Përgjithshme kanë ndaluar për kontroll automjetin me drejtues shtetasin Xh. C. dhe pasagjer shtetasin F. M.

Gjatë kontrollit në automjet dhe kontrollit fizik ndaj këtyre 2 shtetasve, janë gjetur doza lënde të dyshuar narkotike kokainë dhe 1 peshore elektronike për ndarjen e kokainës në doza.

Gjithashtu, gjatë kontrollit në banesën e shtetasit Xh. C., shërbimet e Policisë kanë gjetur një sasi municioni luftarak, që u sekuestrua në cilësinë e provës materiale, bashkë me sasinë e kokainës, peshoren elektronike dhe automjetin me të cilin u kapën në flagrancë 2 të arrestuarit",- njofton policia.

K.M/E.H/Shqiptarja.com

TAG: municion luftarak | kokaine | Shirokë | Shkoder

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Basha akuzon se ka aleancë PS-Rithemelimi kundër SPAK, e besoni?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

Ambasadori i BE nga Shkodra: Luftoni korrupsionin, të vijojë reforma në drejtësi! Presion Dumanit nga politika? Gonzato: S'duket i shqetësuar për këtë

13 Prill, 10:48

'Pranverë me kangë', 23 artistë interpretojnë në teatrin "Migjeni" këngë të muzikës së lehtë shqiptare dhe të huaja

Ergys Kavaja

13 Prill, 10:45

Laçi i Cungut i viziton në Shkodër, Qatip Osmani: Duam dy vendet e para, garë në dy fronte

12 Prill, 12:55

Me armë me vete, 36-vjeçari tenton t'i ikë policisë në Vaun e Dejës! Momenti i arrestimit

12 Prill, 09:39

Konflikti mes fqinjëve, 17-vjeçari u qëllua me pistoletë në sy të prindërve! 'Report tv' zbardh detaje të ngjarjes në Bërdicë të Shkodrës

11 Prill, 10:16

Po lëvizte me 625 fara kanabisi me vete, arrestohet 38-vjeçari në Shkodër

11 Prill, 09:52

Një frymë e re për arsimin dhe artin, njihuni me pedagogun që guxon! Edis Kadija rrëfehet në 'Një nga ne'

Xhensila Nako

10 Prill, 20:19

Shkodër/ Plagoset me armë zjarri 17-vjeçari në Bërdicë, policia në kërkim të autorit (EMRI)

10 Prill, 19:43

Fitër Bajrami kremtohet edhe në Shkodër, besimtarët falin namazin

10 Prill, 08:11

Myftiu i Shkodrës mesazh urimi besimtarëve myslimanë: Me zemër të mirë Fiter Bajramin! Të përhapim shpresën dhe tolerancën

9 Prill, 14:42

U kapën duke peshkuar në liqenin e Shkodrës me pajisje me energji elektrike, në hetim 37-vjeçari

9 Prill, 14:39

Shkodër, makina elektrike e policisë bashkiake del nga ruga e përplas mjetin në qendër! Shikoni pamjet

8 Prill, 10:44

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje